| Kodi i lëndës | | Cikli i studimeve | Cikli i parë, Deridiplomike | Fondi i orëve | 2+1 | Numri i kredive ECTS | 4 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emri i lëndës | ANTROPOLOGJIA SOCIOKULTURORE | | | | | | |
| Të dhënat e përgjithshme: | | | | | | | |
| Universiteti Fakulteti , Programi Studimor | Universiteti 'Nënë Tereza' në Shkup Fakulteti i Shkencave sociale<br>Punë dhe Politikë Sociale | | | Viti i studimit & Semestri | Viti I / Semestri I | | |
| Bartësi i lëndës | Prof. Dr. Sunaj Raimi | | Asistenti | Denis Raufi | | | |
| Statusi i lëndës | Obligative | | | Zgjedhore | | x | |

**Qëllimi i lëndës**

Përmes ligjëratave teoriko-kreative, krahasimeve komparative dhe ilustrimeve të shembujve konkret, studentët të mund të pajisen me njohuri të thelluara për lëndën Antropologjia sociokulturore, fushën e studimit të saj, çështjet karakteristike që i hulumton ajo, elementet e ndryshme të kulturës materiale dhe shpirtërore që e karakterizojnë identitetin shkencor të saj. Gjithashtu studentët do të njihen edhe me rëndësinë e kulturës në jetën e përgjithshme të njeriut, me ngjashmëritë dhe dallimet kulturore që ekzistojnë në shoqëritë e ndryshme në botë, me çka do të formonin mendim kritik të tyre për të gjitha fenomenet dhe varietetet socio-kulturore, e cila gjë do t'i ndihmonte t'i dallojnë qartë refleksionet dhe impilikimet e nduarduarshme të kulturave kolorite në jetën sociale të njeriut.

**Korrespondenca dhe korrelativiteti i Programit**

Programi i lëndës Antropologjia sociokulturore korespondon me përmbajtjet e lëndëve të ngjashme, duke qenë në bashkëveprim me lëndët Antropologjia sociale, Antropologjia kulturore, Sociologjia e kulturës, Kulturologjia etj.

**Përmbajtja e lëndës**

1.Lënda e Antropologjisë socio-kulturore, rëndësia e kulturës dhe llojet e saj. 2.Dallimet dhe ngjashmëritë kulturore-simbolet dhe vlerat. 3.Normat shoqërore (zakonore, morale, fetare e juridike) dhe ritualet. 4.Kultura, civilizimi, subkultura dhe kontrakultura. 5.Etnocentrizmi, relativizmi kulturor, kosmopolitizmi dhe pseudokultura. 6.Feja si fenomen socio-kulturor dhe formë e vetëdijes shoqërore. *Kolokviumi i parë.* 7.Antropologjia sociokulturore dhe arti si krijimtari. 8.Arti, kiçi dhe shundi - karakteristikat sociologjike të tyre. 9.Kultura tradicionale dhe maskultura - mekanizmat e përhapjes së tyre. 10.Arti dhe Bohemia si filozofi kulturore-artistike. 11.Krijimtaria artistike, avangardizmi dhe mentaliteti mikroborgjez. 12.Muzika si art – rëndësia, funksionet dhe llojet e saj. *Kolokviumi i dytë.*

**Mënyra e realizimit të mësimdhënies dhe përvetësimit të njohurive** (të shënohet me **bold**)

| Ligjërata | Seminare dhe punëtori | Ushtrime | Punime individuale | Multimedia dhe Internet |
|---|---|---|---|---|
| hulumtime | **Konsultime** | Punë eksperimentale | Punë mentorike | Mësimdhënie terrenike |

Komentet:

**Obligimet e studentëve:**

- Përcjellja e ligjëratave dhe realizimi i detyrave të parapara me plan-programin mësimor
- Pjesëmarrja në konsultime dhe debate lidhur me çështjet që janë objekt ligjërimi
- Mospjesëmarrja në ligjërata dhe konsultime, tërheqë reperkusje në përputhje me dispozitat e Rregullores ECTS
- Metoda e punës dhe korespondenca gjatë takimeve konsultative duhet të jetë interaktive dhe kreative
- Marrëdhënia mësimdhënës-studentë duhet të bazohet në parimin e devotshmërisë akademike dhe akribisë.

**Përcjellja dhe vlerësimi i studentëve:**

(të shënohen me **bold**) vetëm kategoritë relevante dhe në vend të vlerave zero të vendosen vlera përkatëse, në mënyrë që numri i përgjithshëm i kredive nëpër kategoritë e përzgjedhura të korrespondojë me numrin e përgjithshëm të kredive të lëndës;

| | *Orë për javë* | *Numri i javëve* | *Gjithsej orë për lëndën* | *ECTS* |
|---|---|---|---|---|
| Ligjërata | 2 | 15 x 2 | 30 | 1 |
| Ushtrime | 1 | 15 x 1 | 15 | 0.5 |
| Punë e pavarur | 1 | 15 x 1 | 15 | 0.5 |
| Projekt detyra | 1 | 15 x 1 | 15 | 0.5 |
| Mësim shtëpiak | 4 | 15 x 1 | 15 | 0.5 |
| Punim seminarik | 1 | 15 x 1 | 15 | 0.5 |

Nota përfundimtare do të nxirret nga këto elemente:

a) Pjesëmarrja dhe angazhimi.........................10 %
b) Punimi seminarik, Projekti, Prezantimi ...................................................................20 %
c) Dy kolokviume nga 35 pikë .........................70 %

d) Provimi përfundimtar ...................................100 %

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Hulumtime | | | | | |
| Kolokvium | 1 | 15 x 1 | 15 | 0.5 | |
| Vijueshmeri, aktivitet | | | | | |
| Provim | | | | | Gjithsej mund të grumbullohen 100 pikë! |
| ***Gjithsej:*** | | | ***120*** | ***4*** | |

**Sqarim: 1 ECTS = 30 Orë** **ECTS kredi për lëndën /6 = Gjithsej orë për lëndën /301 Semestër = 30 ECTS**

**Kreditë dhe mënyra e zhvillimit të mësimdhënies**

| | Semestri dimëror | **Semestri veror** |
|---|---|---|
| ECTS koeficienti i ngarkesës së studentit | **4** | |
| Numri i orëve nëpër semestra | **120** | |

**Komentet: SISTEMI I VLERËSIMIT**

| Nota | ECTS nota | Suksesi në % | Përkufizimi |
|---|---|---|---|
| **10** | **A** | **91-100%** | **SHKËLQYESHËM** – njohuri të shkëlqyeshme me vetëm disa gabime minore |
| **9** | **B** | **81-90%** | **SHUMË MIRË** – arritje mbi mesatare, por me disa gabime |
| **8** | **C** | **71-80%** | **MIRË** – rezultat në përgjithësi i mirë me disa gabime që vërehen |
| **7** | **D** | **61-70%** | **KËNAQSHËM**- mirë, por me mjaftë gabime |
| **6** | **E** | **51-60%** | **MJAFTON** – rezultatet plotësojnë kriteret minimale |
| **5** | **FX** | **40-50%** | **DOBËT** - kërkohet edhe pak punë nga studenti për të fituar kredit |
| **5** | **F** | **00-39%** | **DOBËT** – kërkohet shumë punë për të fituar kredit. |

**Literaturë themelore**


1. Raimi, Sunaj, (2021), *Sociologji kulture dhe arti,* Grafoteks, Kumanovë.
2. Monaghan, John& Just, Peter, (2007), *Antropologjia social-kulturore*, Ideart, Tiranë.
3. Baumman, Zygmunt, (2009), *Enigma multikulturore, TRI, Shkup.*
4. Aleksandër, Dhima, (2009): *Hyrje në Antropologji,* Botim i dytë, Tiranë, Ideart.
5. Tirta, Mark, (2003), *Etnologjia e shqiptarëve,* Geer, Tiranë.
6. White, Leslie, (1959), *The evolution of culture*, M.G.H. Book Co, New York.
7. Bidney, David, (1953), *Theoretical Antropology,* Columbia University Pres, New York.
8. Çetta, Anton, 1980, *Këngë dasme,* Instituti Albanologjik, Prishtinë.
9. Bardhoshi, Nebi, (2015), *Antropologji e Kanunit*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë.
10. Krasniqi, Mark, (1991), *Nga gurra e traditës*, Zëri, Prishtinë.
11. Gjeçovi, Shtjefen (1989), *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Tiranë, ASHASH, Trashëgimia kulturore shqiptare.


**Literaturë plotësuese**


12. Mos, Marsel. (1982), *Sociologija i antropologija*, Beograd, Prosveta.
13. Durham, Edith, (1998), *Brenga e Ballkanit,* Argeta-LMG, Tiranë.
14. Beqja, Hamit, (1989), *Rrjedhave të sociologjisë së edukatës e të kulturës*, 8 Nëntori, Tiranë.
15. Barnard, A. (2000), *History and theory in anthropology,* Cambridge University Press, Cambridge.
16. Herzfeld, M. (2001), *Anthropology: Theoretical practice in culture and society*, UNESCO, Oxford.
17. Hasluck, Margaret. (2005.), *Kanuni - Ligji i pashkruar shqiptar*, Lisitan, Lezhë.


**Zhvillimi i kompetencave të përgjithshme dhe specifike (dituri dhe aftësi):**

- Pajisja e studentëve me njohuri, dituri dhe informacione të ndryshme nga fusha e Antropologjisë sociokulturore
- Mprehja e 'ndijave hulumtuese' të studentëve, që ata të mësohen në mënyrë të pavarur t'i nuhasin, t'i hulumtojnë dhe interpretojnë çështjet e ndryshme që i përkasin fushës së Antropologjisë sociokulturore.
- Frymëzimi dhe etablimi i mënyrës kritike të të menduarit te studentët, me çka ata do dinë t'i vlerësojnë veçoritë, specifikat dhe përparësitë e çështjeve të hulumtuara nga kjo fushë.
- Aplikimi praktik i diturive të fituara nga kjo lëndë shoqërore, gjë që do ta mundësonte një njohje kulturore reciproke mes shoqërive të ndryshme, me çka edhe jeta jonë do të bëhej më kuptimplote dhe më humane.

Data dhe vendi
***03.10.2022, Shkup***

Arsimtari i lëndës
***Prof. dr. Sunaj Raimi***